

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: Agjencia Gjyqimorë të Cilësisë në Arsimin e Lartë

Nr. 384 Prot.

Datë 20.10. 2023

Marrës: Kolegji Universitar "Bedër"

Nr. 285 Prot.

Datë 23.10. 2023

Përmbajtja: Përcillen vendimet e Bordit të Alvedimit

SHËNIM:

REKTORI

Datë 23.10. 2023

Për ndjekje:


1. Dr. Lrena Ghehu
2. Dr. Shyqir Bruçaj
3. Dr. Ardi Omeri
4. Dr. Ada Guren
5. _____



Për dijeni:

1. Jekmet, NJSBC
2. Administratori
3. _____

Afati: NORMAL (ditë) **PRIORITET (ditë)** **URGJENT ()**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME BORDIN E AKREDITIMIT DHE
NDËRKOMBËTARIZIMIN

Nr. 384 Prot.

Tiranë, më 20. 10. 2023

LËNDA: Përcillen vendimet e Bordit të Akreditimit

KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”

Rruga Jordan Misja,

TIRANË

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të radhës, të mbajtur më datë 22 Shtator, mori vendime që lidhen me vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit të disa institucioneve të arsimit të lartë dhe disa programeve të studimit.

Lutemi, gjeni bashkëngjitur, vendimet e Bordit të Akreditimit Nr. 83, 84, 85, 86, 87 dhe 88, datë 22.09.2023.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se vendimet janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të ASCAL.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Xhiliola Bixheku





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 86, datë 22.09.2023

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER I SHKENCAVE NË “SHKENCA KOMPJUTERIKE” TË KOLEGJIT
UNIVERSITAR “BEDËR”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2023, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “**Shkenca Kompjuterike**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master i Shkencave në “**Shkenca Kompjuterike**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 329, datë 17.09.2021
- d) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “Bedër”
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Shkencave Kompjuterike
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite / 4 semestra
- g) Kredite (ECTS): 120 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Bedër”

j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimit të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
 1. Kualifikimi i disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, nuk është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
 2. Ngarkesa mësimore e këtij programi studimi, nuk është mbuluar në të gjitha vitet akademike, të paktën në masën 70 % nga personeli akademik me kohë të plotë.
 3. Fondi i literaturës fizike, në funksion të këtij programi studimi, është i kufizuar në numër dhe literatura e detyrueshme e përfshirë në syllabuset e këtij programi studimi, në disa raste nuk është e pesë viteve të fundit.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:


1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Master i Shkencave në **“Shkenca Kompjuterike”**, të Kolegjit Universitar **“Bedër”**.
2. Akreditimin e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite.

3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **21.09.2027**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

ALEXANDER KOHLER




Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN




Anëtar

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

IRAJ HASHI




Anëtar

MAURICE OUDEJANS

Anëtar

LEA YPI




Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shënim: Z. Maurice Oudejans, nuk mori pjesë në këtë mbledhje.

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 86, datë 22.09.2023, “Për akreditimin e parë të programit të studimit Master i Shkencave në “**Shkenca Kompjuterike**”, të **Kolegjit Universitar “Bedër”**, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa që kualifikimi i të gjithë anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, të jetë në përputhje me aktet ligjore e nën ligjore në fuqi.
2. Institucioni, të marrë masa që ngarkesa mësimore e këtij programi studimi, të mbulohet në të gjitha vitet akademike, të paktën në masën 70 % nga personeli akademik me kohë të plotë.
3. Institucioni, të përditësojë literaturën e detyrueshme dhe specifike për të gjitha syllabuset e këtij programi studimi dhe të vazhdojë pasurimin e literaturës fizike në përputhje me syllabuset e përditësuara të lëndëve.
4. Institucioni, të angazhohet për sigurimin e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit, përveç tarifave të studentëve.
5. Institucioni, të konsolidojë mjediset profesionale ku studentët kryejnë praktikat e nevojshme në lidhje me programin e studimit.
6. Institucioni, të përditësojë syllabuset e programit të studimit, në rastet e munguara të titullarit të lëndës, si dhe të përcaktohen temat e detyrave / projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Kolegji Universitar “Bedër”**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

